

UDHËZIM
Nr.24, datë 15.7.2011

**PËR PROCEDURAT E BOTIMIT, SHTYPJES, SHPËRNDARJES DHE SHITJES
SË TEKSTEVE SHKOLLORE TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NGA
SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT UNIVERSITAR**

Në zbatim të vendimit nr.107, datë 10.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.120, datë 27.1.1997 “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor”,

UDHËZOJ:

1. Shtëpia Botuese e Librit Universitar (SHBLU) do të realizojë botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të sistemit parauniversitar, ku përfshihen tekstet për shkollat profesionale (teknike, social-kulturore e të gjuhëve të huaja), si dhe tekstet e pakicave kombëtare greke dhe maqedonase.

2. Në çdo vit, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (MASH) dërgon në SHBLU listën e teksteve të kërkuara për botim. Për secilin tekst dërgohen planet mësimore, tirazhet respektive dhe specifikime të tjera.

3. SHBLU-ja përllogarit koston paraprake, të cilën e dërgon në MASH, për të kërkuar miratimin e fondeve buxhetore të nevojshme.

4. Për secilin tekst të miratuar për botim, SHBLU-ja formon grupet e autorëve, komisionet e posaçme për diskutimin dhe miratimin e teksteve dhe organizon fillimin e procedurës së botimit.

5. SHBLU-ja lidh kontrata paraprake bashkëpunimi me autorët e teksteve.

6. Për të garantuar cilësi të plotë të botimit, ajo zbaton me korrektësi të gjithë skemën teknologjike të përgatitjes së teksteve.

7. Vetëm pas miratimit të tekstit nga këshilli botues i SHBLU-së, nënshkruhet kontrata me autorët dhe bëhet shpërblimi i autorësisë, sipas tarifave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.120, datë 27.1.1997 “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor”.

8. Në rastet e përshtatjes së teksteve të minoritetit grek dhe maqedonas nga versioni shqip, MASH-i siguron edhe lejen e botimit nga botuesi përkatës.

9. Kur tirazhi i teksteve të kërkuara për botim (ose procese të veçanta të tij) nuk realizohet me mundësitë dhe pajisjet teknologjike të SHBLU-së, ajo kooperon me shtëpi botuese apo shtypshkronja të tjera, duke zbatuar procedurat ligjore në fuqi.

10. SHBLU-ja bën kolaudimin e produktit, nënshkruan lejen e qarkullimit, bën publicitetin e tekstit dhe dorëzon 5 kopje të tij në Bibliotekën Kombëtare.

11. Çdo tekst pajiset me ISBN, dhe në kopertinën e tij vendoset çmimi i miratuar nga MASH-i, si dhe pulla me hologramën, e cila sigurohet falas nga MASH-i.

12. SHBLU-ja për të gjitha proceset që lidhen me autorësinë (përfshirë edhe ribotimin e ripunimin), parapërgatitjen, pjesëmarrjen në komisionet e posaçme për diskutimin dhe miratimin e teksteve, zbaton tarifat e shpërblimeve sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.120, datë 27.1.1997 “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera në dokumentacionin shkollor”.

13. Shpërndarja dhe shitja e teksteve do të bëhet nga SHBLU-ja. Drejtoritë e shkollave do të lejojnë shitjen e teksteve në mjediset e tyre dhe sipas kushteve do të vënë në dispozicion të SHBLU-së mjedise magazinuese për tekstet.

14. Të ardhurat nga shitja e teksteve do të derdhen në numrin e llogarisë së të ardhurave të SHBLU-së, dhe do të përdoren sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.424, datë 9.7.1998 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”, pika 1/b, dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nr.33, datë 10.10.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore”.

Të ardhurat nga shitja e teksteve do të derdhen në numrin e llogarisë së të ardhurave në thesar të SHBLU-së, me adresë:

SHTËPIA BOTUESE E LIBRIT UNIVERSITAR, TIRANË

Nr.llogarisë: 0104030780

IBAN Code: AL22202110130000000104030780

15. Në fund të çdo viti, SHBLU-ja dërgon në MASH raportin dhe analizën financiare për realizimin e botimeve.

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi do të përballohen nga buxheti i planifikuar i MASH-it.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Myqerem Tafaj